



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014  
Nr. Dok. 201401675/3

**Lënda:** Rekomandohet " *Marrja e masave me qëllim zbatimin korrekt të dispozitave procedurale, për rastet kur qytetarët kryejnë veprime që vijnë në kundërshtim me vendimin e gjykateve me objekt "Lëshim Urdhër Mbrojtje" dhe dhunë në marrëdhëniet familjare.*

**Drejtuar :** Drejtorit të Policisë së Qarkut  
Z. Ervin HODAJ

**Për dijëni:** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Ardian YLLI

**FIER**

Të nderuar Zotërinj,

Mbi ankesën e bërë nga gazetarët e emisionit "Fiks Fare" të televizionit kombëtar Top-Channel, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, për rastin e ndodhur në datën 02.08.2014, në qytetin e Fierit, kur shtetasi F. M., ka kryer veprime të dhunshme ndaj nënës së tij A. M.

Mbi këtë shqetësim Ndhmës Komisionerët e Avokatit të Popullit kanë shkuar dhe kanë kryer verifikimet e nevojshme në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, nga ku ka rezultuar se:

*Rrethanat e ngjarjes*

Shtetasi F. M., nga qyteti i Fierit, paraqitet person me probleme të shëndetit mendor dhe konkretisht ka diagnozën "Çrregullim psikotik për determinim". Me vendimin nr.582, datë 21.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ai është dënuar me 1 vit e 8 muaj burgim, për veprën penale "Dhuna në familje", kurse në datën 30.05.2012, nga ajo gjykatë është dënuar me 120.000 lek gjobë për veprën penale "Përdorimi me keqdashje të thirrjeve telefonike", ndaj motrës së tij.

Pasi ka kryer dënimin e dhënë nga gjykata, shtetasi F. M., ndodhet i shtruar në spitalin psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, pas vendimit nr.62, datë 26.05.2014, të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me objekt "Lëshim urdhër mbrojtje". Më datën 02.08.2014, shtetasi Fatjon Mollota është larguar pa leje nga spitali dhe rreth orës 01.00 ka shkuar në shtëpinë e nënës së tij A.M., që jeton e vetme. Pasi ka hyrë në banesë ai i ka vendosur duart në fytyrën e nënës, e cila e ka puthur në ballë duke i thënë se po vinte ambulanca. Mandej F., ka larguar duart dhe pasi kanë ardhur punonjësit e policisë e kanë shoqëruar dhe dërguar atë në spitalin psikiatrik Vlorë.

Më datën 04.08.2014, punonjësit e policisë kanë marrë kallëzimin shtetases A. M., ndërsa më datën 13.08.2014, materialet procedurale ia kanë dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo e fundit më datën 04.09.2014, ka rregjistruar procedimin penal nr.1160, për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Veprime që vijnë ndesh me vendimet e gjykatës", parashikuar nga nenet 130/a dhe 321/2 të Kodit Penal. Më datën 22.09.2014, prokuroria ka përpiluar vendimin për kryerjen e ekspertimit psikiatriko ligjor për shtetasin F. M., dhe e ka përcjellë atë në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë. Më datën 24.09.2014, janë marrë deklaratime shtetases A.M., dhe aktualisht po merren masat e nevojshme me qëllim dërgimin e pacientit F. M., nga spitali psikiatrik Vlorë në IML Tiranë, për ekzaminimin e tij dhe përpilimin e aktit të ekspertimit psikiatriko ligjor.

#### Konstatime dhe përfundime

Duke analizuar rrethanat e ngjarjes, qëndrimin e mbajtur nga Policia pas ndodhjes së saj dhe veprimet hetimore të kryera nga organi procedues në procedimin penal nr.1160 të vitit 2014, konstatojmë se:

Pas sinjalizimit të shtetases A. M., për kryerje të veprimeve të dhunshme nga djali i saj F. M., që ishte larguar pa leje nga Spitali Psikiatrik Vlorë, punonjësit e policisë kanë regjistruar menjëherë duke shkuar në vendin e ngjarjes dhe mandej e kanë transportuar atë në spital.

Policia ka patur dijeni lidhur me personalitetin e shtetasit F. M., jo vetëm si person që paraqitet me probleme të shëndetit mendor, por edhe i dënuar me burgim, për veprën penale "Dhuna në familje", ndaj nënës së vet.

Policia është vënë në dijeni se shtetasi F. M., duke shkuar në banesën e nënës së tij Afërdita Mollota ka shkëlur "Urdhërin e mbrojtjes" të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier sipas vendimit nr.62, datë 26.05.2014.

Problemet shqetësuese që pacienti F. M., ka paraqitur në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë Policië i janë bërë me dije nga drejtuesi i atij spitali në shkresën me nr.1084 të datës 29.07.2014.

Drejtorja e Spitalit Psikiatrik Vlorë, më datën 17.07.2014, me të njëjtën shkresë i është drejtuar dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, e cila nga ana e saj më datën 23.07.2014, me shkresën nr.6961/1 ka informuar atë se nuk kishte filluar procedim penal në ngarkim të shtetasit F. M., dhe sqaruar me përmbajtjen e neneve 46 të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale se "Prokuroria dhe Gjykata caktojnë masë mjekësore vetëm ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale".

Për sa sipër, ka qënë detyra e Policisë që me shkuarjen në vëndin e ngjarjes dhe marrjen dijeni për veprën penale, të kryente të gjitha veprimet e nevojshme procedurale, duke aplikuar dhe nenin 251 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale “Arrestimin në flagrancë” të shtetasit F. M., duke vënë në dijeni dhe organin e Prokurorisë. E përmëndim këtë për arsye se, shtetasi F. M., është autor i veprës penale “Veprime që vijnë në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga neni 321/2 e Kodit Penal. Nga ana tjetër, duke kryer veprime të dhunshme ndaj nënës së tij, ai ka kryer dhe veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/ a /4 e Kodit Penal, duke theksuar faktin se e njëjta vepër është kryer në mënyrë të përsëritur.

Rasti, duhet të përbëjë shkak për të analizuar veprimet e Policisë, me qëllim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Gjatë hetimit administrativ, konstatoam gjithashtu se, organi procedues ka kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe ajo që është më e rëndësishme përpilimi i vendimit për kryerjen e ekspertimit psihiatrigo ligjor të shtetasit F. M. Prokuroria ka predispozicionin me qëllim kryerjen e ekzaminimit psihiatrik sa më parë, ndonëse në praktikën e punës ndeshen vështirësi objektive që lidhen me transportin e tij nga spitali psihiatrik i Vlorës për në IML Tiranë. Këtu, duhet një bashkëpunim ndërmjet inskistucioneve për realizimin sa më të shpejtë të këtij veprimi dhe pas administrimit të aktit të ekspertimit mjeko ligjor, dërgimin e akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Dhuna në familje, si një fenomen i përhapur kohët e fundit është konsideruar jo vetëm si një problem i Institucionit të Avokatit të Popullit por dhe i gjithë shoqërisë.

Puna e punonjësit të policisë duhet të jetë e tillë që t'i paraprijë parandalimit të veprave penale dhe për këtë ajo duhet të realizohet në terren, pranë komunitetit dhe në bashkëpunim me organe e qeverisjes vendore.

Pas ndodhjes së veprave penale të dhunës në marrëdhëniet familjare, veprimet e policisë gjyqësore duhet të jenë të shpejta dhe në zbatim të ligjit për masat shtrënguese ndaj autorëve.

Organi i Prokurorisë duhet të drejtojë me profesionalizëm hetimin e ketyre veprave penale brënda një afati sa më shpejtë për dërgimin e çështjes në gjyq. Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut nga administrata publike “ dhe në nenin 21/c të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, ku thuhet se: “Pas përfundimit të hetimeve Avokati i Popullit...., paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,

## **REKOMANDOHET**

Marrjen e masave me qëllim zbatimin e dispozitave procedurale, kur qytetarët kryen veprime që vijnë ndesh me veprimet e gjykatës dhe dhunë në marrëdhëniet familjare.

Analizën e rastit të shtetases A. M., nga qytetit i Fierit, për ngjarjen e datës 02.08.2014, dhe rritjen e efektivitetit të punës nga ana e Policisë së Shtetit, për parandalimin e dhunës në familje.

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brënda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**